

## **DEKLARIMI I SHPENZIMEVE**

### **Zëri në Buxhet “External expertise”**

Zëri i buxhetit të projektit “External Expertise” i referohet shpenzimeve të paguara për shërbime profesionale të kryera nga eksperte të jashtëm, konsulentë apo operatorë të tjerë në varësi të llojit të kontrates apo shërbimit të kryer posaçërisht për realizimin e aktiviteteteve të projektit.

Per deklarimin e shpenzimeve nën zerin External Expertise duhet ti referoheni **DETYRIMISHT** kërkesave të publikuara në seksionin “5.3.4. External expertise” të manualit udhëzues të Programit IPA Adriatik - PMCM<sup>1</sup>.

Nën këtë zë buxheti mund të raportohet shuma totale e kontratave të lidhura për kryerjen e aktiviteteteve që janë tërësisht të lidhura me zbatimin e projektit si psh kontrata për kryerjen e studime, vezhgime, perkthime, koordinim apo menaxhimi financiar të projektit, keshillimet ligjore apo pagesa noteriale.

### **Fee-Based Service Contracts”<sup>2</sup>**

Në rastet e lidhjes së kontratave me ekspertë të jashtëm si “fee-based service contracts” përcaktimi i pagesës/ shpërblimit të ekspertëve, duhet të jetë i arsyeshëm në përputhje me nivelin e eksperincës dhe ekspertizës që do të ofrohet, dhe jo më shumë se niveli i pagës për ore pune/ apo pagës mujore të aplikuar në Shqipëri për kategorinë përkatëse profesionale apo të pranuar përgjithësisht në tregun e punës për pagesat e ekspertëve/konsulentëve në Shqipëri.

---

<sup>1</sup> Program Management and Control Manual (PMCM)  
[http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation\\_documents](http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents) faqe 48-51.

<sup>2</sup> Kontrata që lidhen duke përcaktuar si shpërblim pagën për ore pune apo në baza mujore



Këto kontrata mund të lidhen për kryerjen e një shërbimi të caktuar, duke filluar nga disa ditë dhe deri në përfundim të kohëzgjatjes së projektit (në varësi të intensitetit të shërbimit që kërkohet të përfitohet).

Në ato raste kur kontrata mund të lidhet me ekspertë të jashtëm për një kohë afatgjatë/ për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Shembull konkret i kësaj kategorie kontratash në kuadër të Programit IPA Adriatik janë ato të lidhura për ofrimin e ekspertizës për menaxhimin administrativ dhe financiar të projektit. *Kujdes: Nëse lidhni kontrata me ekspertë të jashtëm dhe shërbimi që ofrohet është afatgjatë<sup>3</sup>, punëdhënësi është i DETYRUAR të paguajë rregullisht kontributet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.*

#### **“Global price contracts”<sup>4</sup>**

Kontratat e shërbimit të njohur si “Global price contracts”, lidhen zakonisht brenda një afati të shkurtër kohor për kryerjen e një studimi të caktuar, vëzhgimi, realizimit të një pyetësori ..etj... pra si pjesë e aktiviteteve të parashikuara në formatin e aplikimit të projektit në zbatim. *Kujdes: Nuk mund të lidhni “Global price contract” në rast se ekspertiza që kërkoni lidhet posaçërisht me detyra të menaxhimit administrativ apo financiar të projektit. Për këtë shërbim aplikohen vetëm “Fee base Contracts”.*

Ne mënyrë që Zeri i buxhetit “External Expertise” të konsiderohet i rregullt për rimbursim nga FLCO duhet të jetë i shoqëruar **DETYRIMISHT** me këto dokumenta mbështetës:

- Dokumentat që provojnë përzgjedhjen e Ekspertit/ teve në respektim të rregullave të prokurimit (shiko shpjegimet e dhena në pjesën “Shënime” pikat i.

---

<sup>3</sup> Në këtë rast ekspertiza mund të ofrohet si me kohë të plotë edhe me kohë të pjesshme për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit

<sup>4</sup> Kontrata e cila e ka të percaktuar shumën e shërbimit për punën e kryer në total, jo mbi baza orare apo mujore



- dhe ii.) dhe dokumentat evidentues për procesin e përzgjedhjes. *Kujdes: Në mënyrë që FLC të mos vonojë lëshimin e DVE jeni të detyruar të bashkangjisni në dokumentat mbështetës të gjithë praktikën e përzgjedhjes të Eksperteve të Jashtëm<sup>5</sup>.*
- Kontraten e lidhur me Ekspertin/tet e Jashtëm, ku të jetë i përcaktuar qartë, ndër të tjera, shërbimi që do të ofrohet në funksion të aktiviteteve të projektit dhe Programit IPA Adriatik. *Kujdes: Kontratat e lidhura me ekspertë të jashtëm të cilët shpërblehen me pagesa mbi baza orare apo ditore, shuma totale e kontratës, numri i ditëve/oreve si dhe shpërblimi për ditë/ ore pune duhet të përcaktohet detyrimisht në kontratë.*
  - Ekspertët e Jashtëm të kontraktuar sipas kontratës “Fee based” (kontrata me kohë të plotë apo të pjesshme) duhet të plotësojnë Time- sheet sipas formatit të publikuar në faqen web të programit IPA Adriatic CBC<sup>6</sup>. *Kujdes: time sheet te plotesuara pa informacionin e plotë, të nevojshem dhe real, te pa firmosura dhe te vulosura per sejcilin nga punonjesit nuk do te pranohen nga zyra e FLC<sup>7</sup>.*
  - Në qoftëse kontrata e lidhur me ekspertin/ tet parashikon ofrimin e shërbimit profesional mbi baza mujore atehere detyrimisht duhet te bashkangjisni në dokumentat mbështetës edhe kopje të liste-pageses (deklarimi online i Tatimeve), formularët e deklarimit (FDP) për sigurimet shoqerore dhe shendetesore si dhe për tatimin mbi të ardhurat nga punesimi, gjithashtu dhe kopjen e urdher xhirimit ku te jete e dukshme firma dhe vula e bankes, ose kopjen e mandatit te pageses se bankes.

<sup>5</sup> Përfshirë këtu: - njoftimin apo publikimin përkatës/ ftesat e derguara eksperteve të përzgjedhur; - raportin e përzgjedhjes të firmosur nga anëtarët e komisionit të ngritur për këtë qëllim; CV dhe dokumentat mbështetës të të gjithë personave të përfshirë në konkurim përfshi edhe ofertat financiare përkatëse. Sygjerohet të përdoren formatet standarte sipas PRAG në versionin Anglisht (*shiko tek pjesa Shënime pikën ii.*)

<sup>6</sup> “time sheet teampalte”

[http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation\\_documents](http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents)

<sup>7</sup> Oret e punes te evidentuara ne time sheet duhet te korrespondojne me oret e punes te reflektuara ne formulën llogaritjes se pages orare per punonjesit qe punojne me kohe te pjesshme ne project.



- Ekspertët e jashtëm të kontraktuar sipas “Global Price contract” duhet të plotësojnë dhe të dërgojnë së bashku me dokumentat e tjerë mbështetës “Raportin/et mbi punën e kryer” në përputhje me detyrat e përcaktuara në kontratë. *Kujdes: Mungesa e Raportit/teve mbi punën e kryer, në dokumentat mbështetës do të sjelli vonesa për leshimin e DVE nga zyra e FLC.*
- Jeni të sygjëruar të bashkangjisni çdo produkt<sup>8</sup> të realizuar nga eksperti/tet e jashtëm të kontraktuar. Paraqitja e produkteve të realizuara, ndihmon FLC për vlerësimin pozitiv dhe vërtëtimin që aktiviteti realisht është kryer, në mënyrë që të shmangen vonesat në leshimin e DVE.
- Faturat tatimore të lëshuar nga eksperti i kontraktuar apo kërkesa për rimbursimin e shërbimit nga Eksperti i kontraktuar, në të cilën të përcaktohen saktësisht data, emri i debitorit, titulli apo shkurtimi i titullit të projektit dhe shpjegimi i shërbimit të ofruar në përputhje me kushtet e kontratës së lidhur<sup>9</sup>.
- Në raste kur Ekspertët e Jashtëm marrin pjesë në aktivitete në funksion të realizimit të projektit, të ashtëquajturat shpenzime për “udhëtim apo akomodim”, do të raportohen vetëm nën zërin në buxhet “External Expertise”. *Kujdes: Në këtë rast jeni të detyruar të paraqisni të gjitha dokumentat mbështetës për udhëtimin e kryer<sup>10</sup>, mungesa në dokumentat mbështetës do të sjelli vonesa për leshimin e DVE nga zyra e FLC.*

---

<sup>8</sup> Psh. Një kopje të studimit të realizuar, pyetësorit të plotësuar, fletëpalosjes/ guidave, prezantimeve PP apo në formatin word, apo çdo produkt tjetër të realizuar nga aktivitetet e projektit.

<sup>9</sup> Përcaktimi i titullit të projektit (apo titullit të shkurtuar) në faturën e lëshuar nga eksperti është element tepër i nevojshëm në mënyrë që të lidhet shpenzimi i kryer me aktivitetin konkret të projektit, me qëllim shmangien e dublimit të financimit të projektit në zbatim dhe të financuar nga programi IPA Adriatik.

<sup>10</sup> Urdheri i shërbimit/ misionit, Ftesa nga organizatori, axhenda, lista e pjesëmarrësve, bording pass, faturat e mundshme të taksise, trenit.. etj, faturat e hotelit dhe të ushqimit etj. *Për më shume informacion në lidhje me dokumentat që duhet të bashkangjiten referoju zërit në buxhet 5.3.3 “Travel and accommodation” te PMCM.*



- Transfertat bankare për të vërtetuar që shpenzimi është kryer realisht, apo kopjen e urdher xhirimit ku të jetë e dukshme firma dhe vula e bankës, ose kopjen e mandatit të pagesës së bankës.
- Ne sistemin MIS perpara se te mbyllet Raport Progresi duhet te ngarkohet (uplodohet) “Contract award declaration”<sup>11</sup>. Një kopje të këtij dokumenti duhet ti bashkangjitet dokumentave mbështetes që do të dërgohen në zyrën e FLC.  
*Kujdes : Mungesa në dokumentat mbështetës të “Contract award declaration” do te sjelli vonesa per leshimin e DVE nga zyra e FLC.*

**Shenime:** i. Përzgjedhja e Eksperteve të Jashtëm - External Experts është vetëm subjekt i rregullave të prokurimit në përputhje dhe në zbatim të nenin 121 te Rregullores Zbatuese IPA 718/2007<sup>12</sup>.

ii. Përfituesit Shqiptarë janë të sygjerruar ti referohen “Practical Guide to Contract procedures for EU external actions” – të njohura si “PRAG”<sup>13</sup> dhe të plotësojnë formateve standarte të publikuara në këtë

<sup>11</sup> Këtë dokument e gjeni të publikuar në website të programi [http://www.adriaticipacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation\\_documents](http://www.adriaticipacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents) referoju “Reporting Pack – Contract award declaration”.

<sup>12</sup> Referoju seksionit “4.2. Public procurement” te PMCM faqe 32, Në përputhje me nenin 121(1) të rregullores së implementimit IPA, procedurat e prokurimit në të gjithë zonën e programit ndërkufitar si në vendet anëtare, dhe në vendet përfituese duhet të ndjekin dispozitat e Kapitullit 3 të pjesës 2, Titulli IV të rregullores financiare dhe Kapitulli 3 i pjesës 2, Titulli III të rregullores së komisionit (EC, Euroatom) nr.2342/2002 të datës 23 dhjetor 2002 5 që parashikojnë rregullat për implementimin e rregullores së Këshillit (EC, Euroatom) nr.1605/2002 si dhe vendimin e Komisionit C(2007)2034 mbi “Rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Evropiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta”.

<sup>13</sup> [http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical\\_guide/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm)



*link<sup>14</sup>. Kujtesë: Kërkesat e “PRAG” nuk janë të detyrueshme por vetëm indikative. Në cdo rast duhet të respektohen vetëm kërkesat e nenit 121 të Rregullores IPA 718/2007.*

*iii. Shpenzimet e kryera nga Ekspertet e Jashtëm për “udhëtim apo akomodim” në funksion të realizimit të aktiviteteve të projektit për tu konsideruar të rregullta për rimbursim duhet të raportohen vetëm nën zërin “External Expertise”.*

*iv. Dokumentat e specifikuar më sipër do të dërgohen pranë zyres të FLCO<sup>15</sup> vetëm pasi të jenë anuluar sipas të dhënave të shpjeguara në PMCM seksionin “6.1.1.3. Voiding expenditure documents” (faqe 72-73) dhe seksionit “6.1.2.3. Attachments to the Progress Report (supporting documents)” faqe 74-75 (shiko edhe footnote 74). **Kujdes: Mos plotësimi i dokumentave sipas kërkesave në seksionet e sipërpermendura do të sjellë vonesa për leshimin e DVE nga zyra e FLC.***

---

<sup>14</sup> Service annexes\_2012, templates b1-b17

<sup>15</sup> Adresa zyrtare: **Zj. Daniela Çekani / Sekretare e Pergjithshme, Ministria e Integritimit, Rruga Papa Gjon Pali II, Tirane Shqiperi.**

